VENDIM
Nr. 189, datë 25.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "KALISI HYDROPOWER" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et "VELESHICA 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 5801 kw DHE "VELESHICA 2", ME KAPACITET TË INSTALUAR 8116 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 13917 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a", nenit 10, pikat 1 dhe 3, 4 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k., si dhe relacionin nr. 111/2 prot., datë 21.11.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, nga HEC-et "Veleshica 1" me kapacitet të instaluar 5801 kw dhe "Veleshica 2", me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total të instaluar 13917 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 739 prot., datë 13.11.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i nenit 26, pika 6, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", me kërkesë të autoritetit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm (Bashkimi i përkohshëm i shoqërive BE-IS sh.p.k. dhe EL – PROM sh.p.k.), me të cilin lidhet kontrata e koncesionit.

- Kontrata e koncesionit nr. 1605 rep. dhe nr. 1037 kol., datë 18.7.2018, "Kontratë koncesionare e formës BOT (Ndërtim, Operim, Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit Veleshicë", është lidhur midis Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV) "Kalisi Hydropower" sh.p.k. në cilësinë e koncesionarit dhe MIE-s në cilësinë e autoritetit kontraktues. Kjo kontratë ka një afat 35-vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- MIE, me shkresën nr. 11068/3 prot., datë 27.12.2018, drejtuar shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k. dhe për dijeni AKBN-së, ka përcjellë te këto të fundit: "Miratimin e projektit zbatimit për ndërtimin e hidrocentraleve "Veleshica 1 dhe Veleshica 2" në pellgun ujëmbledhës të lumit Veleshicë, degë e lumit Drin i Zi, qarku Dibër". Në këtë shkresë MIE fton shoqërinë të nënshkruajë kontratën shtesë të koncesionit në të cilën do të pasqyrohen parametrat në përputhje me projektin e zbatimit.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik për shtrirjen e tubacionit dhe kanalit për HEC Veleshica 2, me nr. 32 prot., datë 3.6.2019 të lidhur midis palëve, Bashkia Kukës në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k., në cilësinë e Qiramarrësit, për një afat 1-vjeçar (njëvjeçar) dhe kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik me nr. 2077 prot., datë 28.3.2019, të lidhur midis

palëve, Bashkia Dibër në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për një afat 10-vjeçar (dhjetëvjeçar).

- Shoqëria ka paraqitur "Leje për përdorim të burimit ujor" me nr. 236 prot., datë 1.7.2019, të miratuar nga KBU Drin–Bunë, për shoqërinë "Kalisi Hydropower" sh.p.k. dhe "Leje për përdorim të burimit ujor" me nr. 236/1 prot., datë 1.7.2019, të miratuar nga KBU Drin–Bunë, për shoqërinë "Kalisi Hydropower" sh.p.k..

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, deklaratën mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 9750 prot., datë 7.12.2018, me nr. 948 identifikimi dhe nr. 57 vendimi, për personin juridik "Kalisi Hydropower" sh.p.k., "Për të zhvilluar projektin ndërtimi i HEC-ve "Veleshica 1 dhe Leveshica 2".

- Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k., ka përcjellë në ERE Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit me nr. 531, datë 18.1.2019, të lidhur midis saj dhe shoqërisë OST sh.a., për HEC-et "Veleshica".

- Aplikimi i shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c"). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2. - (Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria). Vihet re se këto vërtetime mbajnë data hershme dhe si e tillë do t'i kërkohet shoqërisë që në zbatim të rregullores së licencimit t'i paraqesë ato me data të rifreskuara.

- (Marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës). Do t'i kërkohet shoqërisë të bëjë me dije mbi ecurinë e nënshkrimit të kontratës shtesë (nëse ka pasur), pasi vihet re një ndryshim i vlerës së financimit, nga 927.928.007 lekë (sipas kontratës) është ndryshuar në 1.292.524.483 lekë (sipas projektit të zbatimit).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3.

- Neni 9, pika 3, germa "a" (Vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Vërtetimi i lëshuar nga organet kompetente rezulton joaktual.

- Neni 9, pika 3, germa "b" (Bilanci financiar të tre viteve të fundit / ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit). Do t'i kërkohet shoqërisë që për vitet 2016 dhe 2017 të paraqesë në ERE bilancet e ortakëve të saj, sipas kërkesës së rregullores.

- Neni 9, pika 3, germa "c" (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Rezulton se shoqëria do të financojë projektin edhe me kredi bankare si e tillë do t'i kërkohet në vijim të dokumentojë në ERE kontratë kredie të mundshme të lidhur me bankat.

- Dokumentacioni teknik për HEC.

Neni 9, pika 4.1.1, Të dhëna specifike për HEC-in.

Neni 9, pika 4.1.2, Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik.

Neni 9, pika 4.1.4, germa "a" (Studimi i fizibilitetit).

Neni 9,pika 4.1.4, germa "b" (Grafiku i zbatimit të Projektit).

Neni 9, pika 4.1.4, germa "d" (Plani i biznesit).

- Leje nga institucione të tjera.

Neni 9, pika 4.1.5, germa "a" (Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes).

Neni 9, pika 4.1.5, germa "b" (Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike).

Neni 9, pika 4.1.5, germa "c" (Leje mjedisore).

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4, të nenit 8, të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

- Në pikën 4, të nenit 8, të rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" parashikohet se: "Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes se lejeve nga institucionet e tjera".

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Veleshica 1"; me kapacitet të instaluar 5801 kw dhe Veleshica 2" me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total 13917 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-s
Erjola Sadushi